



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 qershor 2013
Nr.ref.:RK424/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin KI 119/11

Sadri Mazreku

**Vlerësim i Vendimit të Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr.
90/2004), të 10 qershorit 2005**

dhe të

**Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, PKL Nr. 120/08,
të 1 shtatorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Kërkesa

1. Kërkesa është parashtruar nga Sadri Mazreku, nga Malisheva (Parashtruesi i kërkesës).
2. Parashtruesi i kërkesës cek Vendimin e Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr. 90/2004), të 10 qershorit 2005, i cili i është dorëzuar më 22 korrik 2007, si vendim përfundimtar.
3. Përveç vendimit të cekur, parashtruesi i kërkesës përmend aktgjykimet e tjera: Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, KA. Nr. 14/2008, të 27 gushtit 2008; Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan, KA. Nr. 14/2008, të 7 tetorit 2008; dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, PKL. Nr. 120/08, të 1 shtatorit 2009.
4. Parashtruesi i kërkesës përmend aktgjykimet e tjera si provë në lidhje me kontestin për pronën dhe parashtroi kërkesë “për shkak të padrejtësisë në emërimin dhe riemërimin e gjyqtarëve si SL dhe HB”.
5. Parashtruesi kërkon nga Gjykata “që për shkelësit e qëllimshëm të ligjit SL dhe HB (...) të konkludohet se ata janë shkelës të vetëdijshëm të ligjit me rekomandim për shkarkimin e tyre për shkak të veprave penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare”.
6. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk tregon se cila është baza kushtetuese e kërkesës, nuk cek se cilat janë shkeljet e pretenduara të Kushtetutës dhe nuk shpjegon se pse faktet e paraqitura shkelin të drejtat kushtetuese.
7. Kërkesa me sa duket bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 27 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatë

8. Më 26 gusht 2011, parashtruesi i kërkesës i parashtroi kërkesën Gjykatës.
9. Më 1 shtator 2011, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj gjyqtare raportuese si dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Iliriana Islami.
10. Më 26 nëntor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues si dhe Kolegjin e ri shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu, meqenëse gjyqtaret Iliriana Islami dhe Gjyljeta Mushkolaj kishin përfunduar mandatin e tyre në Gjykatë.
11. Më 29 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Në një datë të paspecifikuar të vitit 2004, ka filluar procedura gjyqësore në Gjykatën Komunale në Malishevë për të siguruar të drejtën e pretenduar për pronën, që kaloi nëpërmjet Gjykatës Komunale në Deçan deri në Gjykatën Supreme.
13. Më 1 shtator 2009, Gjykata Supreme (P. kl. Nr. 120/08) ka vendosur për kërkesën e Prokurorit të Shtetit në Kosovë për mbrojtjen e ligjshmërisë, të parashtruar kundër vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Deçan (KA. Nr. 14/2008), të 9 tetorit 2008, ku Sadri Mazreku (parashtruesi i kërkesës) ka qenë “paditës subsidiar”.
14. Gjykata Supreme arriti në përfundim se “kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar. Më tej konkludoi se “me vendimin e përmendur janë kryer shkelje të dispozitave të neneve 304 deri 316 të KPPK në favor të të pandehurit Emrush Kastrati”.
15. Megjithatë, Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se “pasi që konform nenit 457 paragrafi 2 të KPPK-së, kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e bazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Malishevë ka pasur një shkelje të nenit 113 (paragrafi 1, pika 7) të Kushtetutës” (sic).
17. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon: “Prona ime dhe prona e 18 trashëgimtarëve tjerë ka qenë e gëzuar vetëm nga Hamdi Mazreku, me ç’rast, me Aktgjykimin e formës së prerë na janë cenuar të drejtat në pronë”.

Pranueshmëria e kërkesës

18. Para së gjithash, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
19. Në atë rast, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], i cili përcakton:
 1. *Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
20. Në shqyrtimin e kërkesës së afatit ligjor, Gjykata vëren se neni 56 (Rastet paraprake) të Ligjit parasheh:

“Afatet e përcaktuara në këtë ligj për fillimin e një procedure për çështjet për të cilat është kompetente Gjykata Kushtetuese dhe të cilat janë ngritur para hyrjes në fuqi të këtij ligji fillojnë të llogariten në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

21. Nga ana tjetër, neni 49 (Afatet) i Ligjit thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.

22. Përveç kësaj, rregulli 36 (1) b) dhe (3) h) të Rregullores së punës parasheh:

1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv te parashtuesi;

3. Po ashtu, një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese, kur:

h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën.

23. Duke marrë parasysh këto dispozita ligjore, duhet konkluduar se juridiksioni kohor i Gjykatës Kushtetuese për rastet paraprake fillon në datën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, e që ishte më 15 qershor 2008 dhe vazhdon deri më 15 maj 2009, që do të thotë katër muaj (shih nenin 49 të Ligjit) pas hyrjes në fuqi të Ligjit, që ishte më 15 janar 2009.
24. Gjykata vëren se, në këtë rast, vendimi i cekur i formës së prerë i Gjykatës Komunale në Malishevë (C. nr. 90/2004), është i datës 10 qershor 2005 dhe i është dorëzuar parashtuesit më 22 korrik 2007.
25. Pra, ky vendim është dërguar dhe dorëzuar para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, më 15 qershor 2008.
26. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të merret me një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (Shih aktvendimet e Gjykatës për pranueshmërinë në Rastin Nr. 18/10, Denic et al i 17 gushtit 2011 dhe në Rastin Nr. KI152/11: Bekim Murati, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Kosovës, i 20 qershorit 2012).
27. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.
28. Për më tepër, Gjykata vlerëson se, edhe në qoftë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme (PKL. Nr. 120/08), i 1 shtatorit 2009, do të mund të merrej si vendim përfundimtar për t'u kontestuar, kërkesa sërish do të ishte e paafatshme.
29. Në fakt, Gjykata vëren se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është nxjerrë më 1 shtator 2009.
30. Gjykata më tej vëren se parashtuesi i kërkesës parashtroi kërkesë më 26 gusht 2011, që do të thotë gati njëzet muaj pas afatit kohor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

31. Prandaj, kërkesa është e paafatshme, sepse nuk i ishte parashtruar Gjykatës në përputhje me nenin 49 të Ligjit, dhe në këtë mënyrë nuk ishte parashtruar në mënyrë ligjore, siç parashihet me nenin 113 (1) të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhshmëri me nenin 113 të Kushtetutës; me nenin 49 e me nenin 56 të Ligjit; dhe me rregullin 36 (1) b) dhe (3) h) të Rregullores së punës, më 4 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani